

Shtatë kompani që operojnë në biznesin “fason” çertifikohen me ISO 9001:2008

Meta: “Çertifikatat ISO, si pasaportat biometrike për biznesin shqiptar në Europë”

Shtatë kompani që operojnë në biznesin fason, biznes i cili përfaqëson mbi 30% të eksporteve shqiptare, janë çertifikuar me ISO 9001:2008.

Në ceremoninë e zhvilluar në ambientet e kompanisë “Center Shqiptare”, ka marrë pjesë Zv. Kryeministri dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, z. Ilir Meta i cili i ka krahasuar çertifikatat me pasaportat biometrike për biznesin shqiptar.



“Produktet e prodhuara nga kompani, sistemet e menaxhimit të cilësisë së të cilave janë konform standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2008 do të mund të konkurrojnë denjësisht në tregjet rajonale e globale.

Marrja e çertifikatës së cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, do të thotë se tashmë keni krijuar një biznes tepër konkurrues për tregjet ndërkombëtare; dhe se keni ndërtuar kapacitete reale që

premtojnë më shumë produkte dhe shërbime që i përgjigjen kërkesave të konsumatorëve evropianë e atyre ndërkombëtare”- ka theksuar Meta.

Më tej ai ka thënë se “produktet e shoqëruara me çertifikatat ISO janë si çështja e pasaportave biometrike për qytetarët shqiptarë. Jo vetëm qytetarët tanë të lëvizim lirshëm por edhe produktet tona njëkohësisht të lëvizin dhe të konkurrojnë në mënyrën më dinjitoze në tregjet evropiane e ndërkombëtare”.

Në ceremoni morën pjesë edhe deputetët Nasip Naço dhe Lefter Maliqi, Kryetari i Unionit të Dhomave të Tregtisë, Ilir Zhilla, Kryetari i Dhomës së Fasonëve të Shqipërisë Gjergji Gjika, si edhe përfaqësues të USAID-it dhe Kooperacionit Italian.

Çertifikatat, në mënyrë simbolike, iu dorëzuan kompanive “Meko 98”, “Lorna”, “Ola-1”, “Stella”, “Venalisa”, “Center Shqiptare” dhe “Patrik” nga Zv. Kryeministri dhe **Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, z. Meta.**

Organizmi që çertifikoi sistemet e menaxhimit të cilësisë së këtyre kompanive ishte instituti italian “Certificazione Di Qualita” (CDQ) antar i Rrjetit Ndërkombëtar të Cilësisë (IQNET).

Në zhvillimin e këtij sektori të ekonomisë një kontribut të çmuar kanë edhe donatorët, sikurse është programi i financuar nga USAID “Rritje Albania”, programi i GTZ-së në mbështetje të sektorit të konfeksioneve, kooperacionit italian përmes kredive të buta për SME-të dhe

programeve të shumta të Komisionit Evropian, të cilat, po ndihmojnë për të çuar më tej drejt niveleve ndërkombëtare dhe tregjeve evropiane produktet “made in Albania”.

Për më tepër informacion rreth çertifikimit sipas standardit ISO 9001, rëndësisë për biznesin dhe kërkesave të tij, dhe se ku mund të gjendet më lirë dhe më shpejt dhe në gjuhën shqipe ky standard, ju lutemi na kontaktoni në:

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Rruga “Mine Peza”, Nr. 143/3, 1014 – Tiranë

Kutia Postare Nr. 98

Tel: +355 (04) 222 62 55

Fax: +355 (04) 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al;